

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.02.2023*

22.02.2023  
Ora 11:05

**RENDI I DITËS**

**Projektakti “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2023.”**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

**1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Z. Ilirjan Celibashi**

**2.Stafi KQZ:**

**Znj. M. Koja, Z. E. Meta,**

**Znj. V. Ballgjini, Znj. A. Tahiraj.**

• **Parti Politike:**

**PDIU (Z. Klardi Xhemali)**

• **Të tjerë:**

**KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëmëngjesi të gjithëve! Atëhere, në seancën e sotme publike në rend të ditës kemi tre çështje për shqyrtim: Projektvendimi për miratimin e materialit ndihmës për trajnimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Pika e dytë ka të bëjë me vlerësimin e raportit mbi monitorimin e veprimtarisë së institucioneve publike për periudhën 10 Shkurt - 16 Shkurt 2023. Çështja e tretë që është çëshjte e mbartur është projektvendimi për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare për vitin 2023. Këtë projektvendimin për shpërndarjen e fondeve do ta shtyjme pas datës 31 Mars pasi do të presim meqenëse është afati i fundit për dorëzimin e raporteve vjetore financiare për vitin 2022. Pasi lidhet shpërndajra e fondeve drejtpërsëdrejti me dorëzimin e raportit financiar vjetor.

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.02.2023*

Kështu që do ta shtyjme pas datës 31 Mars. Pasi ligji thotë ato parti politike që nuk dorëzojnë raportin vjetor të vitit para rendës nuk përfitojnë nga shpërndarja e fondeve.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita CAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.02.2023*

22.02.2023  
Ora 11:05

**RENDI I DITËS**

*Projektakti “Për miratimin e materialit ndihmës për trajnimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.”*

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Znj. M. Koja, Z. E. Meta,

Znj. V. Ballgjini, Znj. A. Tahiraj.

• **Parti Politike:**

PDIU (Z. Klardi Xhemali)

• **Të tjerë:**

KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Dakord, mirë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

**Z. E. Meta:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përmbushje të kompetencës së parashikuar në nenin 19 pika 1 shkronja “gj” të Kodit Zgjedhor drejton procesin e trajnimit dhe të kualifikimit të administratës zgjedhore. Materiali ndihmës për trajnimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore është material që iu vjen në ndihmë trajnerëve të administratës zgjedhore për zhvillimin e trajnimeve por edhe vetë Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor sidomos për aspekte të organizimit dhe funksionimit të tyre. Në këtë material ka informacion mbi përbërjen e KZAZ, kushtet për emërimin, lirim apo shkarkimin e anëtarit të KZAZ, mbledhjet e saj,

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.02.2023*

vendimarrja në kushte të zakonshme dhe në kushtet e vakancave të krijuara në KZAZ. Në materialin ndihmës janë parashikuar detyra funksionale të KZAZ që lidhen me Komisionet e Qendrave të Votimit që në momentin e krijimit të tyre, emërimin e anëtarëve të KQV, emërimin e vëzhguesve, dhe me përcaktimin e anëtarit të shtatë të KQV. Materiali shpjegon akreditimin e vëzhguesve nga ana e KZAZ dhe procedurën që ajo ndjek për përmbushjen e kësaj kompetence të deleguar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duke përfshirë edhe verifikimin e dokumentacionit dhe vendimmarrjen e saj. Materiali ndihmës ka parashikuar edhe procedurat që KZAZ ndjek për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe lista shumemërore për kandidatë anëtarë të këshillit bashkiak të paraqitura nga partia politike apo të propozuar nga zgjedhësit. Në këtë pjesë janë sqaruar dokumentacioni që duhet të depozitohet, verifikimi që KZAZ kryen si dhe vendimarrja e saj për regjistrim apo mosregjistrim të shqyrtimit të kërkesave të paraqitura nga subjektet zgjedhore. Materiali ndihmës trajton edhe çështjen e rëndësishme për mirëadministrimin e procesit zgjedhor që lidhet me dokumentacionin e saj të punës si dhe me njohjen e materialeve dhe dokumentacionit që KZAZ shpërndan për çdo Qendër Votimi. Duke qenë se ky material është në ndihmë të trajnimeve të KZAZ është parë e arësyeshme që të konsultohet edhe me shoqërinë civile. Materiali i konsultuar me organizatat e shoqërisë civile, vetëm Komisioni Shqiptar i Helsinkit ka parashtruar disa sugjerime. Sugjerimi për përfshirjen përgjegjësisë penale të komisionerëve vlerësohet së është i drejtë dhe përmirëson materialin dhe kjo do të përfshihet në tekstin e tij gjatë zbardhjes. Lidhur me sugjerimin mbi lustrimin në formë shembujsh në materialin ndihmës të rasteve mbi mos prezencën e anëtarëve të anëtarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor apo mos publikimin e anëtarësisë së tyre sqarohet se: materiali është konceptuar si një

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.02.2023*

përmbledhje e detyrave të KZAZ-së bazuar në Kodin Zgjedhor dhe akteve të miratuara nga organet drejtuese të KQZ-së. Shëmbuj praktik të aktivitetit të KZAZ-së janë pjesë e trajnimit të KZAZ-së. Trajnimi i KZAZ-së mbështetet në interaktivitetin e tyre sipas një matrice didaktike shoqëruar me materiale ndihmëse. Nga ana tjetër trajnerët në përmbushje të detyrave të tyre kanë edhe monitorimin e veprimitarisë së KZAZ-së. Kjo mendojmë se do të sjellë rritjen e bashkëpunimit të administratës zgjedhore me trajnerët dhe rrjedhimisht me përmbushjen në nivel më të lart të detyrave të ngarkuara për administratën zgjedhore. Ndërsa sugjerimi për të realizuar në kohë trajnimin e KZAZ-së është i drejtë dhe KQZ tashmë ka hartuar planin, skemën e trajnimit të tyre, ka përzgjedhur dhe trajnuar trajnerët e administratës zgjedhore dhe është në proces për kryerjen e trajnimeve të KZAZ-së. Bashkëlidhur projektvendimi dhe materiali për shqyrtim dhe miratim.

**Z. I. Celibashi:** Nga përfaqësuesit e partive politike? Nuk kemi! Atëhere, e miratojmë projektvendimin sipas draftit të propozuar.

**Vendimi nr. 69**

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.02.2023*

22.02.2023  
Ora 11:13

**RENDI I DITËS**

*“Vijimi i hetimit administrativ për shkelje të konstatuara për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, qendrore dhe vendore si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, për periudhën 10 shkurt – 16 shkurt 2023.”*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Znj. M. Koja, Z. E. Meta,**  
**Znj. V. Ballgjini, Znj. A. Tahiraj.**
- **Parti Politike:**      **PDIU (Z. Klardi Xhemali)**
- **Të tjerë:**      **KRIIK**

**Z.I.Celibashi:** Kalojmë tek pika e dytë që ka të bëjë me vlerësimin e raportit mbi monitorimin e veprimtarisë së institucioneve publike për periudhën 10 Shkurt - 16 Shkurt 2023.

**Znj. M. Koja:** Atëhere, për periudhën e monitorimit nga data 10 Shkurt deri më datën 16 Shkurt 2023. Janë raportuar në total 244 aktivitete nga të cilat konstatohet se 39 prej tyre të zhvilluara nga 16 institucione janë në shkelje të afatit ligjor. U është kërkuar informacion institucioneve dhe të gjitha kanë paraqitur argumentet dhe pretendimet e tyre. Jemi në fazën e vlerësimit të tyre dhe në përfundim të

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.22.02.2023*

hetimit do të dalim me vendimmarrjen përkatëse ditën e Premte në seancën publike, të Komisionerit. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Kemi listën e institucioneve se për cilat institucione bëhet fjalë?

**Znj. M. Koja:** Janë 16 institucione janë të nivelit qendror dhe vendor, janë edhe agjensi ndërmjet tyre. Po e kemi patjetër.

**Z. I. Celibashi:** Në rregull! Dakord, do të vazhdojmë ditën e Premte me vendimmarrjen pas vlerësimit të gjetjeve. Çështje të tjera në rendin e ditës nuk kemi. Përpara se ta përfundojmë do të duhet që të risjellim edhe njëherë në vëmendje të kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore pra të kryetareve të bashkisë, detyrimin që ata kanë për të njoftuar zgjedhësit mbi vendndodhjen e QV për secilin prej tyre. Kemi marrë disa raporte nga disa prej kryetarëve të bashkisë po është shumë pak. Me këtë rast ta risjellim përsëri në vëmendje të tyre këtë detyrim që buron nga Kodi Zgjedhor ndërkohë vlen thirja dhe për vetë zgjedhësit për të kontrolluar emrin e tyre në listën e zgjedhësve. Po gjithësesi këtë jemi duke e bërë edhe nëpërmjet fushatës edukuese edhe informuese në media dhe në rrjetet sociale. Pra, ajo çfarë ka rëndësi është që ta risjellim edhe njëherë në vëmendje të kryetarit të bashkisë këtë detyrim të tyre dhe ndërkohë të bëjë një vlerësim paraprakë të ambjenteve ku do të vendosen Qendrat e Votimit edhe pse duket sikur ka shumë kohë deri më 14 Maj por ndërkohë e kemi të nevojshme të dimë se si është situata e ambjenteve ku do të vendosen këto Qendra Votimi, në kuptim të infrastructures, lidhjes me energjinë elektrike, e të tjera. Në rregull, tua bëjmë edhe zyrtarisht këtë sjelljen në vëmendje edhe për këtë të dytën. Seanca mbyllet, ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*

